

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-15/02-06

Prishtinë, 10 shkurt 2006, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 110 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Zgjedhja e kryetarit të Kosovës

Në fillim të seancës **kryetari** i përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë seancë.

Ai i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës të kësaj seance, në të cilën duhej të zgjidhej kryetari i Kosovës, ngase kryetari i mëparshëm, dr. Ibrahim Rugova, vdiq më 21 janar 2006.

1. Zgjedhja e kryetarit të Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e LDK-së që ta paraqiste kandidatin e saj për kryetar të Kosovës.

Deputeti **Kolë Berisha**, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për kryetar të Kosovës e propozoi prof.dr, Fatmir Sejdiun.

Në vazhdim, ai paraqiti biografinë e prof. Sejdiut dhe kërkoi nga deputetët e Kuvendit të votonin për kandidatin e propozuar.

Deputeti **Hashim Thaçi**, paraqiti pikëpamjet e Partisë Demokratike të Kosovës për zhvillimin e proceseve politike në vend.

Ai i ftoi të gjitha forcat politike (të pozitës dhe të opozitës) për solidarizim në ndërtimin e institucioneve demokratike të Kosovës – shtet të pavarur dhe sovran.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit Zgjedhor nga Departamenti Ligjor në përbërje:

Defrim Krasniqi, Sali Rexhepi dhe Xheladin Hoxha, që t'i bënin të gjitha përgatitjet administrative dhe teknike për votim.

I ftoi edhe grupet parlamentare që ta caktonin nga një vëzhgues në Komisionin Zgjedhor, për të vëzhguar punën e tij, gjatë numërimit të votave.

Pastaj, kryetari filloi t'i thërrasë për votim, me emër nga dy deputetë, sipas radhës së alfabetit.

Pas përfundimit të votimit, Komisioni Zgjedhor i numëroi rezultatet e votimit, i vëzhguar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Komisioni Zgjedhor ia paraqiti raportin e votimit kryetarit të Kuvendit.

Kryetari i kumtoi rezultatet e votimit, si vijon:

Votuan 110 deputetë.

**Për78,
Kundër8,
Të pavlefshme; 24 fletëvotime.**

Sipas këtij rezultati, votimi duhet të përsëritet.

Kryetari filloi t'i thërrasë për votim, me emër nga dy deputetë, sipas radhës së alfabetit.

Pas përfundimit të votimit, Komisioni Zgjedhor i numëroi rezultatet e votimit, nën vëzhgimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Komisioni Zgjedhor ia paraqiti raportin e votimit kryetarit të Kuvendit.

Kryetari i kumtoi rezultatet e votimit, si vijon:

Gjithsej votuan 110 deputetë.

**Për77,
Kundër9,
Të pavlefshme : 24 fletëvotime.**

Edhe sipas këtij rezultati, votimi duhet të përsëritet.

Kryetari filloi t'i thërrasë për votim, me emër nga dy deputetë, sipas radhës së alfabetit.

Pas përfundimit të votimit, Komisioni Zgjedhor i numëroi rezultatet e votimit, nën vëzhgimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Komisioni Zgjedhor ia paraqiti raportin e votimit kryetarit të Kuvendit.

Kryetari i kumtoi rezultatet e votimit, si vijon:

Gjithsej votuan 109 deputetë.

**Për80,
Kundër12,
Të pavlefshme: 17 fletëvotime.**

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, në raundin e tretë, me dy të tretat e votave, zgjodhi kryetar të Kosovës prof.dr. **Fatmir Sejdiun**.

Kryetari i Kuvendit e ftoi kryetarin e sapo zgjedhur të Kosovës për t'u paraqitur para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Kosovës, prof.dr. **Fatmir Sejdiu** tha: *"Beto hem solemnisht se do t'i ruaj dhe do t'i mbroj unitetin e popullit, tërësinë tokësore të vendit dhe do të siguroj funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës"*.

Presidenca e Kosovës, nën udhëheqjen time, do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e tjera të Kosovës, me partitë politike në pushtet dhe në opozitë, me grupet etnike dhe me të gjithë qytetarët e Kosovës.

Do të vazhdoj bashkëpunimin e ngushtë me UNMIK-un dhe KFOR-in, TMK-në dhe SHPK-në, për t'i forcuar më tej institucionet e Kosovës dhe sigurinë e vendit.

Do të kem angazhim parësor udhëheqjen dhe vazhdimin e punës së Ekipit Negociator të Kosovës si ekip i unitetit.

Zotohem se unë dhe ekipi im do të bashkëpunojmë ngushtë me SHBA-të, Unionin Evropian dhe Grupin e Kontaktit, me qëllim që Kosovën ta bëjmë shtet paqeje me veten dhe me fqinjët e saj, një vend që do t'i garantojë të gjitha liritë qytetare, njerëzore dhe të pakicave, në pajtim me standardet më të larta që ka vendosur bota demokratike. Dhe në të njëjtën kohë do ta shprehim denjësinë tonë për të qenë partner i integruar në strukturat evropatlantike.

Kryetari i Kuvendit e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:00 minuta.

E hartoi :
Kosovës

Kryetari i Kuvendit të

Akademik **Nexhat DACI**

Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

